



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**PROCESVERBAL <sup>1</sup>**

*(I përmbledhur)*

Tiranë, më 01.02.2019, ora 10.00

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

**Rendi i Ditës :**

- 1. Vijimi i diskutimit dhe miratimi i Projektregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së.*
- 2. Diskutimi mbi ecurinë dhe vijimin e bashkëpunimit të KED me EURALIUS për vitin 2019.*

**Marrin pjesë :**

- |                          |                      |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani        | Kryetar              |
| 2. Vitore Tusha          | Zëvendës kryetare    |
| 3. Arta Marku            | Anëtare              |
| 4. Fatri Islamaj         | Anëtar               |
| 5. Margarita Buhali      | Anëtare              |
| 6. Fatjona Memçaj        | Anëtare              |
| 7. Eriol Roshi           | Anëtar               |
| 8. Medi Bici             | Anëtar zëvendësues   |
| 9. Klodiana Veizi (Mema) | Anëtare zëvendësuese |

<sup>1</sup>Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.
3. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.
4. Klotilda Bushka, deputete anëtare e Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :**

1. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
2. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

**HAPET MBLEDHJA**

***Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani***, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

***Ardian Dvorani*** informon se për motive të komandimit në gjykime jashtë Tiranës, ishte e pamundur pjesëmarrja në këtë mbledhje për anëtarin zëvendësues Gurali Brahimllari.

Lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht.

*1. Vijimi i diskutimit dhe miratimi i Projektregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së.*

*2. Diskutimi mbi ecurinë dhe vijimin e bashkëpunimit të KED me EURALIUS për vitin 2019.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

***Anëtarët e Këshillit miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.***

Këshilli fillon diskutimin mbi pikën e parë të rendit të ditës. Lidhur me dispozitat e Projektregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Diskutimi vijon aty ku ishte ndërprerë në mbledhjen e kaluar, duke filluar nga neni 10 i Projektregullores.

**Anëtarët e Këshillit diskutojnë** për përmbajtjen e nenit 10 “Përgatitja e mbledhjeve të Këshillit”, nenit 11 “Thirrja dhe kohëzgjatja e mbledhjeve të Këshillit” dhe neni 12 “Njoftimet për thirrjen e mbledhjes së Këshillit” të Projektregullores, veçanërisht lidhur me nismën dhe mënyrën e ndërtimit të rendit të ditës dhe të thirrjes së mbledhjes, si edhe rolin e kryetarit të Këshillit në përgatitjen e mbledhjes së tij.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se ka një përmirësim në nenin 11 në krahasim me dispozitën e mëparshme. Janë adresuar çështjet që u ngritën në këtë Këshill, por ende nuk njihet e drejta e anëtarëve për të kërkuar thirrjen e mbledhjes në rast se kryetari apo nënkryetari nuk e vendosin këtë. Nuk jemi në rastin e parashikuar në pikën 1 dhe 2 sipas të cilit parimisht vendoset që në mbledhjen para-ardhëse se kur do të bëhet mbledhja. Ky është organ *ad hoc* dhe si organ i tillë nuk është i mbledhur gjithmonë. Nëse në një moment të caktuar nuk është i mbledhur dhe Këshilli ose secili prej anëtarëve të tij e ndjen që ndoshta ka një problem për të cilin kërkon të mblidhet, kjo e drejtë duhet të jetë e garantuar. Për këtë duhet të njihet e drejta e 1/3 e anëtarëve, të kërkojnë thirrjen e mbledhjes. Ky propozim është në përputhje me nenin 6 të ligjit për organet kolegjiale. Është vendosur, e drejta e 1/3 së numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Por ndoshta edhe është harruar sepse dispozita e lidh këtë vetëm me pamundësinë objektive apo pengesën ligjore si të kryetarit dhe të zëvendësuesit të kryetarit. Pra, teorikisht duhet të garantohet edhe e drejta e anëtarëve për thirrjen e mbledhjes dhe rendin e ditës.

**Anëtarët e Këshillit diskutojnë** për përmirësimin e përmbajtjes së nenit 12 “Njoftimet për thirrjen e mbledhjes së Këshillit”.

Në vijim, diskutimi vijon, **në parim**, edhe në funksion të përmbajtjes së pikës 11 të nenit 12 e të dispozitave që vijnë, mbi çështjet që kanë të bëjnë me kuptimin dhe interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjit nr.115/2016 në përmbajtjen e dispozitave të propozuara të kësaj Projektregulloreje, veçanërisht mbi natyrën e detyrueshme ose jo të njoftimit, pjesëmarrjes dhe/ose të drejtës së fjalës në mbledhjet e Këshillit, të Avokatit të Popullit dhe të subjekteve që ftohen sipas ligjit në mbledhjet e tij, për njohjen e tyre me materialet e çështjeve, mbi qëllimin, natyrën dhe dallimin e pozicionit të tyre si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit, si edhe mbi natyrën e mbyllur të mbledhjes dhe të

respektimit të ndalimit kundrejt përgjegjësisë ligjore që kanë anëtarët në rastin e bërjes publike të diskutimeve të tyre ose anëtarëve të tjerë të Këshillit.

*Erinda Ballanca* kërkon fjalën dhe parashtrohet se nuk e kuptojmë përse është parashikuar që Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhje pa të drejtë fjale. Kemi bërë një material me shkrim në lidhje me këtë çështje dhe për këtë arsye i qëndroj atyre që kemi paraqitur me shkrim për sa i përket rolit, natyrës dhe pjesëmarrjes dhe me shumë kënaqësi e vërejmë që ka një konsensus në Këshill në lidhje me rolin, natyrën dhe faktin që Avokati i Popullit duhet të paraqesë rekomandime. Do ta ushtrojmë këtë kompetencë, detyrim dhe përgjegjësinë që në fakt ka përcaktuar ligji në mënyrën më të mirë të mundshme dhe me përgjegjësinë maksimale. Asnjë veprimtari e Avokatit të Popullit apo anëtarëve të tjerë të Këshillit nuk mund të jetë përtej parashikimit të nenit 218. Aty përcaktohet kush është funksioni i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe mënyra se si ky Këshill do ta ushtroje funksionin e vet. Pikërisht për të garantuar pikën 2, krijohet e gjithë struktura se si organizohet mbledhja, a janë të hapura apo të mbyllura mbledhjet, ka edhe një dispozitë që tregon se deri ku shkon sekreti në lidhje me këtë veprimtari. Duhet të garantohet transparencja dhe të jenë të gjithë të përgjegjshëm për natyrën e vendimmarrjes dhe të votës. Garancia ose detyrimet e këtij organi janë deri aty që vendimmarrja duhet të ketë një arsyetim qoftë për vendimmarrjen pozitive qoftë për atë negative përse një subjekt nuk e ka kualifikuar apo e ka renditur në një vend tjetër.

Prandaj edhe rekomandimet e Avokatit të Popullit mund të shkojmë deri aty sa ai ka kompetencat e veta kushtetuese dhe për të garantuar mbrojtjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut si dhe faktin që respektohet ky standard në gjykim, për të siguruar cilësinë e lartë morale e profesionale në përbërjen e këtij organi. E drejta e fjalës si edhe rekomandimi e jo vendimi i Avokatit të Popullit duhet të garantohet sepse besueshmëria e organeve krijohet jo vetëm nëpërmjet veprimtarisë, por edhe nëpërmjet faktit që secili prej nesh duhet ta dijë mendimin e tjetrit, qoftë edhe përpara vendimmarrjes, në mënyrë që të shpreh qëndrimin e rekomandimin tim në media, se si e kam gjetur punën e Këshillit. Ajo është shumatorja e atyre rekomandimeve që praktikisht duhet të bëjë me dije Këshillit, të cilin sigurisht mund ta merrni ose jo parasysh dhe të keni vendimmarrjet tuaja përkatëse.

Organizimi i punës së KED rregullohet me ligj dhe të qenit të ftuar dhe pjesëmarrja e të ftuarve të tjerë në mbledhje, janë çështje që nuk duhet diskutuar. Qëndrimi apo dhënia e mendimeve prej të ftuarve është diskutim tjetër. Ata mund të japin mendim, kjo besoj për të garantuar transparencën më të madhe të mundshme në punën e Këshillit, duke qenë se mbledhjet janë të mbyllura. Për sa i përket pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit kjo duhet që

të garantohet sikundër i garantohet Kryetarit të Kuvendit apo Presidentit që mund të dërgojë një përfaqësues, kur mund ta ketë të pamundur fizikisht pjesëmarrjen në mbledhje, duke sjellë kualitetet më të mirë të institucionit për të qenë pjesë në këto mbledhje.

Nisur nga sa parashikohet në ligj nuk shikojmë asnjë mundësi ligjore që KED të mblidhet në dhomë këshillimi. Kur ka një mundësi për të qenë dhomë këshillimi kjo parashikohet nga ligji. Por KED është organ me natyrë administrative dhe jo gjyqësore për efekt të vendimmarrjes dhe nuk përcaktohet në asnjë dispozitë që mund të ketë dhomë këshillimi. Ato janë vetëm në organe të natyrës gjyqësore.

Rolin e OMN e kemi përmendur sepse duhet të kemi një lloj garancie në vlerësimin e kritereve të pasurisë dhe kritereve të tjera të përcaktuara për kandidatët dhe nuk shikojmë të ketë gjë të keqe që të mos kemi vetëm një mendje, pra të kemi vetëm të relatorit, por të kemi me shumë mendje për të arritur atë që është qëllimi. Janë pikërisht këto lloj kompetencash apo parashikime të natyrës *check & ballance* që i jepen Avokatit të Popullit apo të ftuarve të tjerë për të pasur një lloj garancie e jo një hipoteze të këtij Këshilli në lidhje me këtë vendimmarrje.

Për sa i përket të drejtës së fjalës mendoj se mund të jetë objekti i ndonjë parashikimi me kufij kohor për nevojën që të përdoret gjithmonë në mënyrën më të drejtë të mundshme, duke respektuar kohën e gjithsecilit.

Mbledhjet janë të mbyllura ndaj publikut dhe personave të tretë. Tek pjesa e transparencës parashikohet se kush duhet të jenë në mbledhje. Parimi është me dyer të mbyllura për gjithkënd por jo për Avokatin e Popullit dhe të ftuarit që janë parashikuar në nenin 233. Këtu përcaktohet edhe se si Këshilli duhet të komunikojë me publikun, pra përcakton jo vetëm transparencën me gjithë publikun, por edhe parashikon që të komunikojë “të paktën” “më së paku për:“. Kur themi kështu do të thotë se këto janë minimumi i atyre që ti duhet të komunikosh me publikun, mund të komunikosh edhe me shumë nëse vendos por këto me patjetër sepse ky është minimumi i transparencës që ti duhet të garantosh.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe parashtron se për sa i takon pjesëmarrjes në mbledhjet këshillit të institucioneve të ftuara, ajo është shkruajtur dhe konsiderohet e mirëqenë në ligj dhe e thënë drejtpërdrejt nga ligjvënësi. Të paktën edhe se si unë e interpretoj si jurist dhe si përfaqësues i Presidentit të Republikës, të tërë këto organe që ftohen të jenë të pranishëm nisin proceset e tyre, pra janë organe emërtese/mbështetëse, që do të thotë p.sh. se, kur shpallet vakanca në Gjykatën Kushtetuese, Presidenti shpall vakancën e tij dhe bashkëpunon më tej me Këshillin. Në këtë pozitë rrjedhin më tej dispozitat e ligjit kur parashikojnë se ftohen të jenë të pranishëm, pra për të qenë pranë edhe për të dhënë mendim,

sidomos në këtë proces fillestar. Kështu që, i gjithë arsyetimi që bëri Avokati i Popullit mua më duket i drejtë dhe do të dëshironim që, të ftoheshim në të gjitha mbledhjet ashtu siç dispozita ligjore parashikon. Rolin se sa ne si përfaqësues të institucioneve të ftuara mund të japim mendim, opinion, sugjerim etj., ky është kufiri që ligji e ka lënë për të ftuarit, dhe atë do ta vlerësojë Këshilli. Ndërsa siç kërkuat këtë mendim në mbledhjen e sotme, ju do të kërkonit përsëri mendim dhe ne përsëri do ta japim, gjithmonë në formatin e mendimit, opinionit të natyrës se si ne e shikojmë zbatimin e ligjit. Për sa i takon bërjes publike ose përgjegjësisë disiplinore të anëtarit të Këshillit, meqenëse jemi tek kjo dispozitë e fundit e rregullores për bërjen publike të mendimeve që ka dhënë ose janë dhënë nga anëtarët e tjerë gjatë procesit të diskutimit të çështjes, kjo ka të bëjë me veprimet aktive të anëtarit të Këshillit, nuk ka të bëjë me riskun që këto mendime do të shfaqen nga ne si të ftuar në publik. Ka të bëjë drejtpërdrejtë me përgjegjësinë e këtij Këshillit.

**Klotilda Bushka** kërkon fjalën dhe parashtron se bie dakord me shumicën e atyre që u diskutuan, pra që të ftohen përfaqësuesit e Presidentit dhe të Komisionit të Ligjeve sepse ndërsa pjesëmarrja e tyre mund të jetë fakultative, detyrimi i Këshillit për ti njoftuar është tashmë i parashikuar me ligj. Për sa i takon çështjes se deri ku dhe çfarë nënkupton kjo pjesëmarrje, sigurisht kjo është një çështje që i takon këtij Këshilli ta vendosë. Si përfaqësuese politike qëndrimin e kam shumë të qartë dhe nuk e besoj se është vetëm i imi, por i gjithë grupit politik që përfaqësoj. Ne nuk do të dëshironim të kishim një rol aktiv në diskutim në këtë Këshill për efekt të asaj që është më e rëndësishme në këtë proces, e që është pavarësia e këtij Këshilli për të vendosur në baza objektive pandikueshmërie mbi ato çështje që janë në kompetencat e tij. Sigurisht kur ka një çështje që nevojitet të konsultohemi, nuk mund të përcaktohet që nuk ka të drejtë fjale. Por, në parim, do të donim të ishim thjesht në rolin e të ftuarit, ashtu si e parashikon ligji, pa pasur ndërhyrje në diskutime për efekt të faktit që edhe transparenca që ka detyrim ky Këshill duhet të jetë e lidhur edhe me çfarë diskutohet këtu. Çdo lloj diskutimi i yni në lidhje me meritat e çështjeve mund të keqkuptohen në sy të publikut, duke cenuar besimin e tyre tek ky proces, duke prekur atë që për ne është shumë e rëndësishme politikisht, besimin e publikut dhe zbatimin e reformës në drejtësi.

Për sa i takon rolit të Avokatit të Popullit, neni 149 i Kushtetutës, ashtu si dhe neni 233 i ligjit, e parashikon atë në rolin e vëzhguesit. Dhe kur themi vëzhgues, veprimtaria ka të bëjë me faktin e monitorimit dhe një veprimtari e tillë nënkupton ndjekjen e një procesi pa qenë në fakt në rol superaktiv. Roli që i ka dhënë Kushtetuta dhe qëllimi i kushtetutëbërësit në atë moment ka qenë për të garantuar pikërisht elementin e procesit të rregullt dhe çështjen

e pavarësisë. Prandaj është zgjedhur ky institucion i pavarur, i cili, si vëzhgues, dëgjon e monitoron dhe sigurisht jep rekomandime sepse këtë e bën ai që monitoron, prodhon një raport, i cili, me pas, është në çmim të organit përkatës ta marrë ose jo në konsideratë. Ky Këshill është organ kolegjal dhe ka detyrimet e veta të funksionojë sipas ligjit.

Për sa i takon faktit që mbledhjet janë me dyer të mbyllura apo të hapura, unë gjykoj që për sa kohë ka një parashikim që mbledhjet janë të mbyllura, fakti se çfarë do të parashikoni ju në rregullore ka të bëjë në fakt edhe me detyrime etike që kanë anëtarët e vetë këtij Këshilli sa i takon mënyrës se si funksionojnë, se si përcillet informacioni, por mund të jenë edhe detyrime për të ftuarit që mund të vendosen në rregulloret tuaja si pengesa. Më konkretisht për diskutimet e anëtarëve të Këshillit për një çështje të caktuar mund të parashikohet në rregullore që për sa kohë mbledhjen janë me dyer të mbyllura është detyrim për të gjithë ta ruajnë konfidencialitetin dhe të jemi të kujdesshëm, gjithmonë me arsyetimin se në nenin 233/2 është qartë e parashikuar se vetë Këshilli ka një mënyrë komunikimi me publikun, është vetë Këshilli që njofton publikun për vendimin e marrë, arsyetimin e vendimit e për çdo gjë.

*Enkelejd Alibeaj* kërkon fjalën dhe parashtron se çështjet që diskutohen në parim, në thelb, janë dy. Një çështje është pjesëmarrja e Avokatit të Popullit dhe e të ftuarve. Çështja tjetër është statusi i tyre. Këto dy çështje janë çështje garancish të natyrës kushtetuese, me interes për diskutim jo vetëm brenda kësaj tryeze, por edhe në sfondin e frymës së ndryshimeve kushtetuese, rolit dhe pozicionit që kanë organet e reja. Kushdo që e ka sjellë këtë lloj projekti është nisur nga fjalët se mbledhjet janë të mbyllura. Por, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk është sekt okult. Madje kjo qasje duhet të shikohet edhe situatën aktuale ku jeni juve në këtë Këshill. Tre anëtarë të shortuar nga Kuvendi kanë mangësi në legjitimitetin e tyre kushtetues dhe ligjor dhe, së dyti, katër anëtarë të tjerë nuk i janë nënshtruar ende procesit të vettingut, janë nën presion të pastër për vendimmarrje dhe ky është opinionimi im i qarte dhe i grupit që unë përfaqësoj. Këtij sfondi, ti shtosh edhe idenë se mbledhjet do të jenë të mbyllura, nuk do të ftohen subjektet në çdo rast, madje edhe fjala nuk u jepet në çdo rast, edhe mbledhjet në momente të caktuara mund të bëhen në dhomë këshillimi, kjo nuk është gjë tjetër veçse ta pranosh dhe ta celebrosh, e para presionin politik që ndjeni dhe e dyta ti nënshtrorsh presionit politik. Mbledhjet bëhen të mbyllura, jo për të mos marrë pjesë ata çfarë ligji i cakton, por të mos marrin pjesë media edhe publiku.

Rregulli bazë i një demokracie është ndarja e pushteteve dhe mekanizmi i kontrollit dhe balancës. Këtë mekanizëm, Kushtetuta dhe ligji e ka parashikuar që ta garantojë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të Avokatit të Popullit dhe pjesëmarrjes jo fakultative të

subjekteve që ky Këshill i konsideron si të ftuar. Teknikisht ligji përcakton se “ftohen” të marrin pjesë por nuk thotë “mund të”. Pra, Këshilli ka detyrimin të ftojë subjektet, nëse nuk vijnë kjo është çështja e përgjegjësisë së tyre publike.

Titulli i nenit është “Transparenca”, e në kushtet kur edhe procesverbali i mbledhjes publikohet i përmbledhur, veprimtaria juaj sipas ligjit është e mbyllur në dhomë të errët, do të thotë se është detyrim njoftimi drejtuar subjekteve për pjesëmarrje në mbledhje. Me këtë rast, është e treta mbledhje që operohet në kundërshtim me ligjin sepse sipas ligjit për funksionimin e organeve kolegjiale nuk fillon mbledhja pa kaluar një herë procesverbali i mbledhjes se mëparshme.

Për sa i përket të drejtave të Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuar në mbledhjet e Këshillit, ata kanë të drejtë fjale, sipas radhës dhe të limituar në kohë, për të kontrolluar që Këshilli e bën detyrën, duke i shprehur mendimet në mbledhje dhe jo jashtë saj, ku pastaj qëndrimet kanë ngarkesë tjetër politike e publike. Mund të diskutohet nëse të ftuarve do ti jepen materialet përpara mbledhjes.

Avokati i Popullit, i cili për çdo vit, raporton edhe në Kuvend, jo vetëm merr pjesë në mbledhje me të drejtën e fjalës në kushte të barabarta me anëtarët, por merr pjesë edhe në veprimtari jashtë plenare, si monitorues i procedurës që ndiqet në rastin e vlerësimit, verifikimit dhe renditjes së kandidaturave, e cila, nëse shkelet, ngarkon Këshillin edhe me përgjegjësi disiplinore. I vetmi ndryshim i rolit të Avokatit të Popullit kundrejt anëtarëve të Këshillit është se nuk ka të drejtë vote. Avokati i Popullit rekomandon në kohën e duhur dhe që ta monitorojë procedurën duhet të jetë pjesëmarrëse në kohë reale në të gjitha veprimet, në mbledhje por edhe përpara mbledhjes.

Së fundi, pjesëmarrja e përfaqësuesit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe dy deputetëve, kurrsesi nuk duhet të konsiderohet si një mjet që mund të influencojë për keq në vendimmarrjen e Këshillit. Nëse Këshilli ka këtë vlerësim tregon mungesë të eksperiencës për të mbajtur këtë lloj presioni pozitiv prej publikut, të cilin subjektet e përfaqësojnë ose tregon që nuk do të jetë ligji, objektiviteti dhe uniformiteti në vlerësim që do të udhëheqin veprimtarinë e Këshillit.

*Ardian Dvorani* pasi merr mendimin e pjesëmarrësve cakton një pushim 30 minuta.

## **PJESA E DYTË E MBLEDHJES**

*Ardian Dvorani* fton përfaqësuesit e EURALIUS nëse vlerësojnë të shprehin mendimet e tyre.



*Klodjan Rado* merr fjalën dhe parashtron se si gjatë KED 2018, ashtu edhe gjatë KED 2019, EURALIUS-i ka paraqitur me shkrim në fakt qëndrimet e veta, ka komunikuar edhe për projektin në vazhdim. Duke u fokusuar tek çështjet që u diskutuan gjatë në këtë mbledhje, mbi rolin e Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë, mendojmë që duhet trajtuar në tre nivele: çështja e njoftimit, çështja e nivelit të pjesëmarrjes aktive në mbledhje dhe çështja e tretë shpërndarja ose jo e materialeve. Çështja e materialeve ndoshta edhe mund të diskutohet në kuadër të dispozitave që duhet të shqyrtohen dhe diskutohen më vonë.

EURALIUS i bashkohet mendimeve në mbledhje në lidhje me njoftimin e Avokatit të Popullit i cili njoftohet natyrisht për çdo mbledhje, madje ky është detyrim ligjor. Tek niveli i pjesëmarrjes aktive dhe në bashkohemi me shumicën, me atë që doli në mënyrë tërësore në këtë takim. Avokati i Popullit duhet të jetë aktiv në mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit, me anë të rekomandimeve dhe formave që ai çmon, pra një lloj monitoruesi i procesit në të gjitha hapat e vet. Në lidhje me materialet e rendit të ditës, Avokati i Popullit duhet të ketë akses të plotë mbi këto materiale sepse edhe roli i tij është monitorues në të gjitha fazat e procesit. Për sa i përket të ftuarve të tjerë, në lidhje me njoftimin rekomandohet që sigurisht të njoftohen për çdo mbledhje sikurse përcakton ligji. Termi është “ftohen”, në fakt nuk është “mund të ftohen”, prandaj duhen ftuar në mbledhje.

Për sa i përket nivelit të pjesëmarrjes aktive, mendojmë që çështja e të drejtës së fjalës së të ftuarve të tjerë të jetë në diskrecionin e KED-së rast pas rasti. Ky është një organ kolegjal dhe, në përgjithësi, kur diskutohen çështje të përgjithshme, të nivelit parimor, sikurse kjo projektregullore, sigurisht që roli dhe kontributi i tyre është shumë i rëndësishëm dhe natyrisht rekomandojmë që duhet pjesëmarrja e tyre sa më aktive. Ndërsa tek çështjet e karakterit individual dhe teknik, tek verifikimi individual i kandidatëve apo edhe tek çështja e renditjes së tyre, rekomandojmë që për nivelin e pjesëmarrjes së të ftuarve të tjerë është KED-ja që duhet të vendosë rast pas rasti për të garantuar pavarësinë dhe mosinflucimin e këtij organi kushtetues nga politika, prandaj kjo të jetë në nivele sa më minimale për të garantuar këtë organ që të jetë tërësisht i pavarur ndaj çdo lloj ndërhyrje.

Për sa i përket materialeve, kur ato lidhen me të dhëna individuale të kandidatëve në këtë proces, të ftuarit e tjerë nuk duhet të kenë akses mbi këto materiale. Ata sigurisht janë këtu që të dëgjojnë gjithçka që thuhet, por aksesin në lidhje me materialet individuale të secilit nga kandidatët rekomandojmë që të mos ta kenë, pikërisht dhe në frymën e Kushtetutës dhe të ligjit e që bën diferencimin ndërmjet rolit të Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë.

*Ardian Dvorani* kërkon që, pas dëgjimit të mendimeve të shprehura nga Avokati i Popullit, përfaqësuesit e subjekteve të ftuara sipas ligjit dhe përfaqësuesit e Euralius, anëtarët e Këshillit të shprehin qëndrimin përfundimtar të tyre lidhur me çështjet e shtruara për diskutim në parim, të finalizuara me votimin përkatës.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me njoftimin dhe ftesën për pjesëmarrje në mbledhje të subjekteve që nuk janë në përbërje të Këshillit.

Në përfundim, *të gjithë anëtarët e Këshillit* u shprehën dhe votuan që duhen njoftuar për të marrë pjesë në mbledhje të gjithë subjektet që nuk janë në përbërje të Këshillit.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me pjesëmarrjen (praninë) e subjekteve të ftuara sipas ligjit, edhe në fazën e bisedimit në të cilën anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen dhe vendimmarrjen e çështjeve konkrete që lidhen me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante, nisur nga nevoja e respektimit të parimit të transparencës dhe e parashikimit ligjor për ndalimin e bërjes publike të diskutimeve të anëtarëve të Këshillit.

Në përfundim, *anëtarët Arta Marku, Fatri Islamaj, Margarita Buhali, Fatojna Memçaj dhe Eriol Roshi* u shprehën dhe votuan që të gjithë pjesëmarrësit jo anëtarë të Këshillit të marrin pjesë edhe në fazën e diskutimit mes anëtarëve edhe për rastet konkrete të lidhura me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante. *Anëtarët Ardian Dvorani dhe Vitore Tusha* u shprehën dhe votuan për kufizimin e pranisë së pjesëmarrësve jo anëtarë në momentin e bisedimit për vendimmarrje të rasteve konkrete të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes konkrete të kandidaturave të vendeve vakante.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me të drejtën e fjalës dhe kufizimin ose jo të saj për Avokatin e Popullit në mbledhjet e Këshillit.

Në përfundim, *të gjithë anëtarët e Këshillit* u shprehën dhe votuan që Avokati i Popullit të ketë të drejtë e fjalës në mbledhjet e Këshillit. Duhet të ketë vetëm një kufizim kohor për fjalën sikurse të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me kufizimin ose jo të së drejtës së fjalës dhe shprehjes së qëndrimeve nga Avokati i Popullit në mbledhjet e Këshillit vetëm në çështje të procedurës apo edhe për vetë meritën e çështjes, kjo për rastet konkrete të lidhura me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante.

Në përfundim, *anëtarët Arta Marku, Fatri Islamaj, Margarita Buhali, Fatojna Memçaj dhe Eriol Roshi* u shprehën dhe votuan për të drejtë të pakufizuar fjale të Avokatit të Popullit, jo vetëm në lidhje me procedurën por edhe për vetë meritën e çështjeve, përfshirë rastet konkrete të lidhura me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante. *Anëtarja Vitore Tusha* u shpreh dhe votoi që kjo e drejtë e Avokatit të Popullit mund të jetë edhe e kufizuar dhe Këshilli mund të vendosë për këtë. *Anëtari Ardian Dvorani* u shpreh dhe votoi për kufizimin e së drejtës së fjalës dhe shprehjes së qëndrimeve nga Avokati i Popullit, duke qenë vetëm vëzhgues në mbledhjet e Këshillit, vetëm në çështje të procedurës dhe jo për meritën e çështjeve konkrete të lidhura me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me të drejtën e fjalës dhe kufizimin ose jo të saj për subjektet që ftohen sipas ligjit të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

Në përfundim, *të gjithë anëtarët e Këshillit* u shprehën dhe votuan që subjektet që ftohen sipas ligjit të kenë të drejtë e fjalës në mbledhjet e Këshillit, por ajo të jetë e kufizuar në çështjet e natyrës së përgjithshme, ndërsa në rastet konkrete të lidhura me verifikimin, vlerësimin dhe renditjen konkrete të kandidaturave të vendeve vakante, e kufizuar vetëm për çështje të procedurës e jo të meritës. *Anëtarja Arta Marku* u shpreh dhe votoi që edhe subjektet që ftohen sipas ligjit, sikurse Avokati i Popullit të kenë të drejtë të pakufizuar fjale.

*Anëtarët e Këshillit* shprehin qëndrimin dhe votën e tyre lidhur me të drejtën e pakufizuar ose jo të Avokatit të Popullit dhe të subjekteve që ftohen sipas ligjit të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, për tu njohur paraprakisht me materialet e çështjeve të rendit të ditës, përfshirë edhe materialet që kanë të bëjnë me procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes konkrete të kandidaturave të vendeve vakante.

Në përfundim, *të gjithë anëtarët e Këshillit* u shprehën dhe votuan që Avokatit të Popullit i dërgohen të gjitha materialet e rendit të ditës, ndërsa subjekteve që ftohen sipas ligjit në mbledhjet e Këshillit, për aq sa është e mundur tu jepen edhe materialet që kanë të bëjnë me procedurat konkrete të verifikimit, vlerësimit dhe renditjes konkrete të kandidaturave të vendeve vakante. Kufizimet përkatëse do të vlerësohen e përcaktohen në aktet nënligjore normative që Këshilli do të miratojë për procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave.

*Anëtarët e Këshillit* diskutojnë për mënyrën se si do të procedojnë me dispozitat e projektregullores, pas përfundimit të diskutimit dhe votimit mbi qëndrimet e Këshillit për disa çështje parimore.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se duhet diskutuar nëse në procesverbalin e mbledhjes do të përfshihen edhe qëndrimi apo rekomandimi i Avokates së Popullit, të cilat për efekt të transparencës duhet të përfshihen.

**Anëtarët e Këshillit** diskutojnë dhe evidentojnë se kjo është e parashikuar në riformulimin që i është bërë nenit 18 të projektregullores.

**Enkelejd Alibeaj** kërkon fjalën dhe parashtron se kanë mbetur katër çështje të rëndësishme parimore që duhen diskutuar: çështja e konfliktit të interesit, çështja e seancës, çështja e procesverbalit të seancës dhe e fundit kompetencat e kryetarit, për të cilën keni rënë dakord në mbledhjen e kaluar. Procesverbali i seancës është teknik, nuk është se ka shumë për të diskutuar. Kam përshtypjen se në një farë mënyre keni rënë dakord për një diskutim përfundimtar edhe për çështjet e tjera. Ka mbetur si çështje e patrajtuar çështja e konfliktit të interesit, e cila, domosdoshmërisht, siç bëjmë në Komision të Ligjeve, duhet analizuar qartë sipas legjislacionit ekzistues dhe pastaj të merret guximi që të replikohet ose jo edhe këtu në këtë mbledhje. Kjo për shkak se besohet që legjislacioni është i plotë. Kurse për tre çështjet e tjera, e këshillueshme do të ishte që të trajtohen pasi të formulohen dispozitat për çështjet që u diskutuan sot, për shkak se deri tani është rënë dakord në parim.

*(diskutime pa mikrofon)*

**Këshilli** diskutoi dhe vendosi të vijohet në mbledhjen e radhës me diskutimin dhe miratimin e dispozitave të projektregullores, si edhe të kalohet në pikën e dytë të rendit të ditës, pra në diskutimin mbi qëndrimin e kërkuar për ecurinë dhe vijimin e bashkëpunimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me EURALIUS për vitin 2019.

**Erinda Ballanca** kërkon fjalën dhe parashtron se kjo është një mbledhje në të cilën EURALIUS-i raporton se cila cili është plani i punës së tyre, çfarë ka ndodhur dhe çfarë është bërë. Pra nuk është ndonjë mbledhje në të cilën ka ndonjë kontribut nga anët e tjera dhe nuk është se duhet të ketë një vendimmarrje të caktuar të Këshillit.

**Enkelejd Alibeaj** kërkon fjalën dhe parashtron se çështja e parë për tu diskutuar është që nëse je i ftuar personalisht, s'ke pse pyet. Nëse je ftuar në cilësinë e përfaqësuesit në marrëdhënie me të tretët, siç ligji përcakton, sigurisht që ke detyrimin të marrësh opinionin. Logjika e do që ose kërkon llogari ose të kërkojnë llogari. Ka një lloj marrëdhënie paraprake midis EURALIUS-it dhe Këshillit të Emërimeve që do të thotë nëse shkohet të kërkohet llogari, normalisht do të duhet të kesh një marrëdhënie bashkëpunimi, pra një marrëveshje, një kontratë ku njëra palë ofron shërbimin, EURALIUS-i në këtë rast, dhe përfituesi i shërbimit shpreh kënaqësi apo jo nga cilësia e dhënies së shërbimit. Kështu janë termat e referencës së EURALIUS-it. E fundit, sigurisht që EURALIUSI duke qenë në një farë

mënyre edhe me ngarkesë të përfaqësimit të Delegacionit, mund ta përdorë, qenien ose jo, përfaqësimin ose jo, në këtë rast, edhe me nota të natyrës politike, në kuptimin që, të detyruar siç janë në bazë të termave të referencës për të rakorduar mbi masën e realizimit të ekzekutimit të reformës në drejtësi ku një përgjegjësi kanë edhe ata që në gjenezë, do të duhet pasur kujdes që veprimtaria reale e këtij Këshilli të mos përdoret apo të mos keqpërdoret për efekt të performancës që duhet të ketë vetë EURALIUS-i.

**Këshilli** ra dakord të vijohet bashkëpunimi i Këshillit me EURALIUS për vitin 2019, pa përcaktuar ndonjë qëndrim tjetër të veçantë.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** duke shpallur zhvillimin e mbledhjes së radhës në datën 01.02.2019, ora 10.00 me rend dite vijimin e diskutimit të dispozitave të projektregullores së brendshme, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

#### **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.12**

**Sekretare**

**Kryetari**

**Redjona Myrtja**

**Ardian Dvorani**

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.  
Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.